REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 shkurt 2023
Nr. ref.:RK 2126/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI149/22

Parashtrues

Fejzi Hajdari

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kml. nr. 2/2021, të 24 shkurtit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fejzi Hajdari, nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Yll Xhiha, avokat nga Komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Kml. nr. 2/2021] të 24 shkurtit 2021, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ka. nr. 491/2020] të 2 dhjetorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [K. nr. 887/2019] të 1 tetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 4 mars 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore si dokument shtesë.

8. Më 10 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. KSH. KI149/22] e caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, (kryesues), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 13 tetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të specifikojë aktin konkret të cilin e konteston, dhe t'i dorëzojë kopjet e të gjitha vendimeve të gjykatave të rregullta si dhe përgjigjen e Prokurorit të Shtetit.

10. Më 19 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi Aktvendimin e Gjykatës Supreme si dokument shtesë.

11. Më 5 dhjetor 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon kohën kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktvendimin e kontestuar.

12. Më 6 dhjetor 2022, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

13. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

14. Më 30 dhjetor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.

15. Më 25 janar 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 14 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës ishte i përfshirë në shkaktim të një aksidenti ku kishte mbetur i lënduar personi R. K. (në tekstin e mëtejmë: i dëmtuari).

17. Më 1 tetor 2020, Gjykata Themelore – Divizioni për Kundërvajtje nxori Aktgjykimin [K. nr. 887/2019] përmes të cilit parashtruesi i kërkesës ishte shpallur përgjegjës nga paragrafi 1 dhe 6 i nenit 19 dhe paragrafi 2 i nenit 255 të Ligjit nr. 05/l-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, si dhe nga neni 35 i Ligjit nr. 05/l-087 për Kundërvajtje duke shqiptuar dënimin me gjobë prej 200 euro dhe kishte udhëzuar të dëmtuarin në kontest civil për realizim të kërkesës pasurore juridike.

18. Më 5 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës së kundërvajtjes, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të ligjit material dhe vendimit mbi dënimin, me arsyetimin se fajtor për shkaktimin e aksidentit nuk është vetëm parashtruesi i kërkesës, me propozimin se vendimi të anulohet dhe rasti të kthehet në rigjykim.

19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë plotësuese para Gjykatës se Apelit, duke kërkuar që *"të vendosë para së gjithash se nuk është zgjeruar procedura kundërvajtëse, veprime këto duke i dhënë kompetenca plotësues vetes së saj dhe është amnistuar padrejtësisht i pandehuri tjetër Rinor Kurtaj përkundër faktit se i njëjti është shpallur bashkëfajtor deri tek aksidenti"*.

20. Më 2 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ka. nr. 491/2020] refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetimin se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës së kundërvajtjes apo aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 12 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, duke iu referuar neneve 384 dhe 432 të Kodit të Procedurës Penale që pretendonte shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale, me propozimin që Aktgjykimi të anulohet dhe rasti të kthehet në rivendosje.

22. Më 24 shkurt 2021, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Kml. nr. 2/2021], duke iu referuar nenit 149 të Ligjit nr. 05/l-087 për Kundërvajtje, refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të palejuar.

23. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës i propozoi Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që të iniciojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

24. Gjykata vëren se nga dosja e lëndës, nuk ka njohuri nëse Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka nxjerrë ndonjë përgjigje në lidhje me propozimin e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e neneve të lartcekura të Kushtetutës ka ndodhur si pasojë e shpalljes së fajësisë vetëm ndaj parashtruesit të kërkesës dhe jo edhe ndaj të dëmtuarit.

27. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson: *"Gjykata Themelore ka shpallur fajtor Fejzi Hajdarin por jo edhe Rinor Kurtaj, Gjykata kundërvajtëse nuk kishte kompetencë lëndore meqenëse ishte Fejzi Hajdari me lëndime trupore të rëndë, operim dhe gjendje kome, shto kësaj ekspertiza e komunikacionit 2 sosh kishte shpallur fajtor 2 persona dhe jo vetëm njërin Fejzi Hajdarin".*

28. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson: *"Është shumë e rëndësishme se Gjykata në një proces të rregullt nuk kishte kompetencë meritore për të vlerësuar një vepër penale e cila bije në domenin e Krimeve të Rënda dhe jo në kundërvajtje, meqenëse Rinor Kurtaj kishte shkaktuar lëndime të rënda trupore që nga një veting të sinqertë kjo vepër do të mund të përfshinte edhe cilësimin juridik shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm [...]".*

29. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Gjykata, në çdo shkallë gjykimi, duhet të marrë në shqyrtim dhe të vendosë në lidhje me kompetencën e saj lëndore, përpara se të gjykojë çështjen që i paraqitet për shqyrtim. Ky detyrim i gjykatës për të vepruar edhe kryesisht, është i lidhur drejtpërdrejt me zbatimin dhe respektimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor, i sanksionuar me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nëse një gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar çështjen, ajo nuk mund të kryej asnjë veprim tjetër procedural në lidhje me të".*

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] Gjykata e Apelit e Kosovës nuk ka vlerësuar drejtë dispozitat e KPRK-së, as edhe Gjykata Themelore meqenëse kanë heshtur parregullsitë e mosekzaminimit të raportit mjekësor të Fejzi Hajdarit, jo vetëm por edhe mendimin e ekspertit të komunikacionit nuk e përfillën, shtrohet pyetja "Për çka shërben atëherë caktimi i ekspertit", në një vendim arbitrar gjyqtarja nuk do të duhej të ndërmerrte këtë veprim procedural të caktimit të ekspertit, derisa ky i fundit ka një prej detyrave të përcaktuara me ligj në nenin 136:"Duhet të jetë në pyetje /fajësia ose pa/fajësia e të pandehurit ose shkalla e dëmit të shkaktuar me vepër penale".*

31. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës thekson: *"[...] karshi shkeljeve të rënda të prezantuara një nga një konsideroj* ***se KPRK është aplikuar gabimisht*** *...".*

32. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se i është drejtuar edhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, por që nuk ka marrë përgjigje.

33. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Kryefjala e gjithë kësaj mjegullnaje që sado përpiqemi të largojmë kujtesën është Sevdije Morina apo Prokurorja e instancës së tretë, paramendoni si fillim i drejtohem me këtë lutje, e njëjta hesht, i drejtohem me e-mail dhe urgjencë, e largon topin duke e dërguar në Gjykatën Supreme dhe më pas kur Gjykata Supreme e kthen tek ajo si kompetencë ekskluzive, Prokuroja i kalon afate kohore që ligjërisht nuk do të duhej të kalonin [...]".*

34. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij ta shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

Rregullorja e punës

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...]."

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

36. Gjykata më tej i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale), çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Kml. nr. 2/2021] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 24 shkurtit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

38. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

39. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston aktvendimin [Kml. nr. 2/2021] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 24 shkurtit 2021. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore vërteton që parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktin e kontestuar më 4 mars 2021. Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 3 tetor 2022 më shumë se 4 (katër) muaj pas pranimit të aktit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajve të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.

40. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që kopja e vendimit të plotfuqishëm të organeve gjyqësore vendase t'i dorëzohet në mënyrë automatike, qëllimit dhe synimit të nenit 49 të Ligjit më së miri do t'i shërbehej nëse afati katërmujor llogaritet nga data kur është dorëzuar kopja e atij vendimi (shih, ndër të tjera, rastin GJEDNJ-së *Worm kundër Austrisë, nr. 83/1996/702/894*, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).

41. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/21, me parashtrues *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; dhe KI45/21, me parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021, paragrafi 35; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-se *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 10865/09,45886/07* dhe 32431/08, të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258).

42. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 e 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 25 janar 2023, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani